

VENDIM
Nr.28, datë 19.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i“““
Manol Konomi,	Anëtar i“““
Zija Vuçi,	Anëtar i“““
Halil Kopani,	Anëtar i“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i“““
Veli Budo,	Anëtar i“““

Me sekretare Drita Filto, më datën 9.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti që i përket:

KËRKUESE: PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE, e përfaqësuar nga Z. Arben Demeti dhe Av.A1do Zadrima.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE përfaqësuar nga sekretari, Z. Thimjo Kondi.

O B J E K T I:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin të pavlefshëm të zgjedhjeve të kryera në datën 29 qershor në zonën elektorale nr.16 Kukës dhe përsëritjen e tyre, sipas nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor" (me ndryshimet).

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës kërkuese, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni i zgjedhjeve të zonës nr .16 Kukës, me vendimin e tij nr .8, datë 1.7.1997 njëzëri ka vendosur që të drejtën për shpalljen e kandidatit fitues apo për përsëritjen e zgjedhjeve t'ia lërë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin e tij nr.1106/2, datë 2.7.1997 shpallur fitues kandidatin e Partisë Demokratike, Z. Jemin Gjana.

Ana kërkuese, në ankimin e saj ka pretenduar se ka patur parregullsi në listat e zgjedhësve të 20 qendrave të votimit, ku mungojnë shumë firma, nuk janë shënuar dokumentet e identifikimit të zgjedhësve, si dhe në 17 qendra votimi të zonës së Fanit nuk janë shvilluar zgjedhjet për mungesë të bazëz materiale.

Nga shqyrtimi i procesverbaleve të qendrave të votimit, është vërtetuar se zgjedhjet janë zhvilluar rregullisht në të gjitha qendrat e votimit dhe se në këto procesverbale nuk janë bërë vërejtje nga pjesëtarët e komisioneve.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 26 e vijuesa të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 datë 29. 4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 " Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë

Tiranë, më 19.7.1997